



Raporti individual i konsultimit publik për projektligjin:

“Për disa ndryshime në ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar.

1. Titulli i projekt aktit

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar.

Ky projektligj ka për qëllim forcimin e mbështetjes financiare shtetërore për projektet dhe veprimtaritë në fushën e mjedisit, nëpërmjet krijimit të Fondit Kombëtar të Mjedisit dhe rregullimit të procedurave të financimit, miratimit dhe menaxhimit të tij.

Nevoja për ndërmarrjen e kësaj nisme ligjore buron nga mungesa e një mekanizmi të qëndrueshëm financiar publik i dedikuar ekskluzivisht mbrojtjes së mjedisit. Aktualisht, financimi i projekteve mjedisore është i shpërndarë dhe jo i sistemuar, gjë që kufizon efektivitetin dhe vijimësinë e politikave kombëtare mjedisore.

Projektligji synon krijimin e një sistemi transparent, të centralizuar dhe të bazuar në kritere të qarta shqyrtuese e vlerësuese, në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira evropiane.

Organet përgjegjëse për administrimin dhe financimin e projekteve, në përputhje me këtë projektligj, janë ministria përgjegjëse për mjedisin dhe kolegji i posaçëm i ngritur pranë saj, i përbërë nga nëpunës të lartë dhe të mesëm të administratës publike.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Kohëzgjatja e konsultimit publik për këtë akt ishte 20 ditë pune nga data e shpalljes së njoftimit në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, bazuar në ligjin 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik.

Publikimi u bë në datë 15.4.2026 dhe nëpërmjet një njoftimi të publikuar online në RENJK, të gjitha palët e interesuara: 1) organet publike; 2) shtetasit e Republikës së Shqipërisë dhe grupet e interesit; ishin të ftuar për të paraqitur komentet dhe rekomandimet e tyre për projektaktin, në adresën e koordinаторit për njoftimin dhe konsultimin publik në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit.

Data e mbylljes së procesit të konsultimit publik ishte 15.5.2026.

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar”, relacioni përkatës si dhe njoftimi për pjesëmarrje në takimet konsultative, u publikuan në linkun, www.konsultimipublik.gov.al.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Projektligji, në zbatim të ligjit 146/2014, i është nënshtruar procesit të konsultimit publik, në portalin “Regjistri elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike”, nga data 15.4.2026 deri në datën 15.5.2026. Përgjatë kësaj periudhe ka patur 5 komente nga z.Rihat Doci si dhe 775 shikime në RENJK.

4. Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Projektakti është hartuar nga Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse në fushën e mjedisit. Gjatë procesit të hartimit janë paraqitur komente dhe sugjerime nga palë të interesuara, me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së tij. Në kuadër të këtij procesi, komente dhe sugjerime janë paraqitur nga z. Rihat Doci, arkitekt i sistemit AKRD, të cilat janë shqyrtuar nga grupi i punës gjatë finalizimit të projektaktit.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

*Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;
Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;
Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.*

Çështja e adresuar (psh. perkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbledhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht /I refuzuar)	Justifikimi
Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar	1.Në mbyllje të konsultimit publik për ligjin 10 431, si projektues i sistemit AKRD, insistojmë që projektligji/aktet nënligjore të saktësojnë "Sistemin e Monitorimit" sipas këtyre kriterëve teknike të panegociueshme: Gjenerimi i Barkodeve dhe Ndërveprueshmëria (AKSHI): Sistemi DRS duhet të jetë i	Z.Rihat Doci	Refuzuar	Komentet e paraqitura janë fokusuar kryesisht në: nevojën për integrimin e sistemeve digjitale dhe fiskale në monitorimin e proceseve mjedisore; propozime për organizimin institucional dhe modelin e administrimit të fondeve dhe sistemeve; rritjen e transparencës dhe

	ndërlidhur me AKSHI-n, i cili shërben si urë komunikimi për gjenerimin dhe verifikimin e barkodeve unike për çdo njësi paketimi. Kjo garanton që asnjë produkt i paregjistruar në sistemet shtetërore të mos lejohet të qarkullojë apo të rimbursohet. Ndërlidhja me Sistemin e Tatimeve: Softueri i menaxhimit të mbetjeve duhet të jetë 100% i integruar me programet aktive të fiskalizimit në Shqipëri. Çdo rimbursim (depozitë) duhet të trajtohet si transaksion i monitorueshëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, duke eliminuar informalitetin dhe "shishet pirate". Ndërfaqe (Dashboard) MinistrORE në Kohë Reale:			gjurmueshmëri së së flukseve financiare dhe të mbetjeve përmes platformave të integruara; përmirësimin e mekanizmave të raportimit dhe monitorimit në mbështetje të zbatimit të politikave mjedisore. Komentet e marra u shqyrtuan nga strukturat përgjegjëse të ministrisë. Një pjesë e sugjerimeve që lidhen me transparencën, monitorimin dhe raportimin e projekteve do të merren në konsideratë gjatë hartimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit. Ndërsa propozimet që lidhen me krijimin e strukturave të reja institucionale
--	--	--	--	---

	Sistemi AKRD dërgon automatikisht të dhënat në një ndërfaqe ministrore, ku institucionet (Ministria e Mjedisit dhe e Financave) shohin në kohë reale sasinë e mbledhura, peshën dhe fluksin monetar. Ky automatizim eliminon nevojën për raportime manuale që janë burim abuzimi. Mbrojtja e Fondit të Mjedisit: Duke përdorur këtë infrastrukturë digjitale, Granti i Mjedisit nuk shkon për "shërbime", por për investim në asete (Makinë RVM dhe Softwer) që integrohen me e-Albania, duke e bërë projektin të vetë-shlyeshëm brenda 12 muajve. Përfundim: Çdo model DRS që nuk garanton integritet real-time me AKSHI		apo modele alternative të administrimit të fondit nuk u reflektuan në projektligj, pasi tejkalojnë objektin dhe qëllimin e kësaj nisme ligjore, e cila synon krijimin e një mekanizmi financiar brenda kuadrit ekzistues institucional. Në përfundim, komentet e paraqitura nuk kanë sjellë nevojën për ndryshime në objektivat, parimet apo strukturën e projektligjit, por kanë kontribuar në qartësimin e aspekteve që do të adresohen në fazën e zbatimit dhe në aktet nënligjore përkatëse.
--	--	--	---

	dhe Tatimet, cenon sigurinë financiare të Fondit të Mjedisit dhe nuk përmbush standardet e transparencës që kërkon Bashkimi Evropian.			
	2. Në vijim të propozimeve për efektivitetin e Fondit Kombëtar të Mjedisit, parashtroj nevojën që aktet nënligjore (VKM/Udhëzime) të saktësojnë modelin e zbatimit si vijon: Struktura Sh.a. dhe Partneriteti: Duke qenë se projektligji synon një sistem transparent dhe të centralizuar (sipas Relacionit), administrimi duhet të kryhet nga një Shoqëri Anonime (Sh.a.) me kapital shtetëror. Ky entitet do të jetë pronari i aseteve (makinerive dhe softuerit) të financuara 100%	Z.Rihat Doci	Refuzuar	Komenti u shqyrtua gjatë procesit të rishikimit të projektaktit por nuk u reflektua në projektligj, pasi çështjet e ngritura lidhen me aspekte që do të trajtohen në fazën e zbatimit dhe në aktet nënligjore përkatëse.

	nga Granti i Mjedisit, duke siguruar që investimi publik të mbetet pronë shtetërore. OJF si Organ Monitorues (Bordi): Për të respektuar Direktivën e BE-së, OJF-të e prodhuesve (PZP) duhet të integrohen si anëtarë të Bordit Drejtues të Sh.a.-së. Ky model siguron që industria të ketë kontroll mbi ecurinë e riciklimit, por pa pasur akses në administrimin e drejtpërdrejtë të fondit apo fitimit, duke eliminuar konfliktin e interesit. Tenderimi Publik i Pajisjeve: Propozojmë që Sh.a. shtetërore të realizojë prokurimin e hapur për blerjen e makinerive RVM dhe shërbimeve teknike. Kjo			
--	---	--	--	--

	procedurë duhet të bazohet në Specifikimet Teknike të Projektit AKRD, i cili garanton integrimin e detyrueshëm me AKSHI (e-Albania). Eliminimi i Barrierave Burokratike: Meqenëse projekti financohet 100% nga shteti, 'eksperienca' e operatorëve privatë jashtë vendit nuk duhet të jetë kriter përjashtues. Garancia e suksesit duhet të bazohet te Përputhshmëria Teknike me Sistemet Kombëtare Digjitale dhe te projekti zbatues që siguron vetë-financimin.			
	3.Në vijim të propozimeve për efektivitetin e Fondit Kombëtar të Mjedisit, parashtroj nevojën që aktet	Z.Rihat Doci	Refuzuar	Komenti u shqyrtua gjatë procesit të rishikimit të projektaktit por nuk u reflektua në projektligj, pasi çështjet e

	nënligjore (VKM/Udhëzim e) të saktësojnë modelin e zbatimit si vijon:Struktura Sh.a. dhe Partneriteti: Duke qenë se projektligji synon një sistem transparent dhe të centralizuar (sipas Relacionit), administrimi duhet të kryhet nga një Shoqëri Anonime (Sh.a.) me kapital shtetëror. Ky entitet do të jetë pronari i aseteve (makinerive dhe softuerit) të financuara 100% nga Granti i Mjedisit, duke siguruar që investimi publik të mbetet pronë shtetërore.OJF si Organ Monitorues (Bordi): Për të respektuar Direktivën e BE-së, OJF-të e prodhuesve (PZP) duhet të			ngritura lidhen me aspekte që do të trajtohen në fazën e zbatimit dhe në aktet nënligjore përkatëse.
--	---	--	--	---

	integrohen si anëtarë të Bordit Drejtues të Sh.a.-së. Ky model siguron që industria të ketë kontroll mbi ecurinë e riciklimit, por pa pasur akses në administrimin e drejtpërdrejtë të fondit apo fitimit, duke eliminuar konfliktin e interesit. Tenderimi Publik i Pajisjeve: Propozojmë që Sh.a. shtetërore të realizojë prokurimin e hapur për blerjen e makinerive RVM dhe shërbimeve teknike. Kjo procedurë duhet të bazohet në Specifikimet Teknike të Projektit AKRD, i cili garanton integrimin e detyrueshëm me AKSHI (e-Albania). Eliminimi i			
--	---	--	--	--

	Barrierave Burokratike: Meqenëse projekti financohet 100% nga shteti, 'eksperienca' e operatorëve privatë jashtë vendit nuk duhet të jetë kriter përjashtues. Garancia e suksesit duhet të bazohet te Përputhshmëria Teknike me Sistemet Kombëtare Digjitale dhe te projekti zbatues që siguron vetë-financimin.			
	4.Parashtroj këto pika thelbësore për rregulloren zbatuese të Nenit 67: Forma Juridike e Administrimit (Sh.a.): Duke qenë se Fondi i Mjedisit parashikon mbështetje financiare për projekte strategjike, administrimi i infrastrukturës	Z.Rihat Doci	Refuzuar	Komenti u shqyrtua gjatë procesit të rishikimit të projektaktit por nuk u reflektua në projektligj, pasi çështjet e ngritura lidhen me aspekte që do të trajtohen në fazën e zbatimit dhe në aktet nënligjore përkatëse.

	kombëtare të riciklimit (DRS) duhet të bëhet përmes një Shoqërie Anonime (Sh.a.) me partneritet shtetëror. Kjo garanton që asetit i krijuar me grant shtetëror të mbetet pronësi publike dhe të auditohet në mënyrë transparente, duke shmangur kalimin e fondeve të entiteteve private (OJF) në kontrollin e shtetit. Modeli i Vetë-financimit: Sistemi i propozuar është një plan i plotë kombëtar i cili parashikohet të funksionojë me vetë-financim të plotë pas fazës së parë të investimit. Ky model garanton që skema e riciklimit të mos rëndojë buxhetin e shtetit në mënyrë të			
--	--	--	--	--

	vazhdueshme, duke u mbështetur te parimi "Prodhuesi Pagues". Roli i Subjekteve të PZP (OJF) pa Përfitim Financiar: Në përputhje me Direktivën e BE-së 94/62/EC, OJF-të e prodhuesve duhet të jenë pjesë e monitorimit përmes përfaqësimit në Bordin Drejtues të Sh.a.-së. Megjithatë, këto subjekte nuk duhet të kenë asnjë të drejtë mbi fitimin apo dividendin që gjenerohet nga asetet e financuara me grant. Ky kusht është jetik për të shmangur konfliktin e interesit dhe abuzimin me fondet publike. Integriteti me AKSHI: Zbatimi i ligjit duhet të kushtëzohet me			
--	--	--	--	--

	integrimin teknik në kohë reale me platformën e-Albania, për të garantuar transparencë totale të transaksioneve dhe rimbursimin e drejtpërdrejtë të qytetarëve. Ky propozim synon mbrojtjen e investimit strategjik të shtetit dhe garantimin e një mjedisi të pastër përmes një sistemi llogaridhënës dhe të pavarur.			
	5.Si projektues i platformës AKRD (Agjencia Kombëtare e Riciklimit Digjital), vlerësoj nismën ligjore për krijimin e Fondit Kombëtar të Mjedisit. Për të garantuar që ky fond të jetë efektiv, propozojmë që ky ligj të	Z.Rihat Doci	Refuzuar	Komenti u shqyrtua gjatë procesit të rishikimit të projektaktit por nuk u reflektua në projektligj, pasi çështjet e ngritura lidhen me aspekte që do të trajtohen në fazën e zbatimit dhe në aktet nënligjore përkatëse.

	mbështetet në një infrastrukturë digjitale të monitorueshme. Propozojmë që projektligji të integrojë Sistemin e Rimbursimit të Depozitës (DRS), i cili: Garanton Transparencë: Përmes integritit me AKSHI, çdo lëvizje e fondit mjedisor monitorohet në kohë reale, duke siguruar që financimi të shkojë direkt te riciklimi i vërtetuar. Zbaton Parimin "Prodhuesi Pagues": Sistemi identifikon ambalazhet përmes teknologjisë RVM, duke detyruar industrinë të marrë përgjegjësi financiare për mbetjet e saj. Performancë e Matshme: Ky			
--	---	--	--	--

	sistem është i vetmi mekanizëm që siguron mbledhjen e mbi 90% të mbetjeve të paketimit brenda një afati 12-mujor, duke përmbushur direktivat e BE-së.			
--	--	--	--	--